



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME

Dokument parlamentar

Tiranë, më 7.11.2023

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2024”

(Shqyrtimi në parim për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme)

HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme në mbledhjen e datës 7.11.2023 (e cila u zhvillua *on line*, nëpërmjet platformës “Zoom”) mori në shqyrtim në parim projektligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2024” për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 78-85 të Rregullores së Kuvendit.

Paraqitja e projektligjit në mbledhjen e Komisionit, u bë nga z. Igli Hasani, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, në prani të përfaqësuesve edhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave. Projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të veçantë shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projekt buxheti i MEPJ për vitin 2024 është pjesë e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026. Hartimi i projektbuxhetit të MEPJ është përgatitur në funksion të aktivitetit diplomatik dhe konsullor të MEPJ, përfshirë këtu edhe misionet diplomatike dhe postet konsullore jashtë vendit. Planifikimi ka në themel objektivat e përcaktuara të Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim si dhe Planin Kombëtar të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian.

Projektbuxheti i MEPJ për vitin 2024 është **rreth 3.2 miliard lekë**. Ky buxhet mundëson vazhdimin normal të përfaqësimit të Shqipërisë në shtetet ku jemi akredituar, si dhe zbatimin e strategjive, politikave dhe objektivave të shërbimit të jashtëm.

Për sa më sipër, orientuar nga prioritetet e politikës së jashtme, projektbuxheti i vitit 2024 mundëson:

Integrimi Evropian si drejtim strategjik i Politikës së Jashtme

- Vijimi i angazhimit politik e diplomatik të MEPJ dhe përfaqësive të veta në shtetet anëtare të BE për avancimin e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
- Forcimi i dialogut me institucionet e BE, në të gjitha nivelet dhe formatet, lidhur me çështje të politikës së përbashkët të jashtme e të sigurisë, përfshirë sanksionet e BE dhe zbatimin e tyre në territorin shqiptar;
- Angazhimi i drejtpërdrejtë në ndjekjen e aspekteve politike të procesit të integritimit evropian me institucionet politike të BE, (Këshilli i Evropës, Parlamenti Evropian, Përfaqësuesi i Lartë për Politikën e Jashtme dhe Çështjet e Sigurisë)
- Ndjekja e kornizës politike të procesit screening dhe të negociatave të anëtarësimit. Ndekja e drejtë për drejtë e të gjitha çështjeve në grup kapituajt e acquis të BE-së, ku MEPJ është kryesuese (kapitulli 31) apo kontribuuese (kriteri politik, kapitulli 23, kapitulli 24 dhe kapitulli 30);

Veprimtari në kuadër të organizatave ndërkombëtare

Fusha e diplomacisë shumëpalëshe do vazhdojë të jetë në vëmendjen e Politikës së jashtme dhe të gjithë strukturave të shërbimit të jashtëm, duke shpërfaqur vlerat e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, dhe duke dhënë kontributin tonë modest për çështjet e paqes dhe të sigurisë në planin ndërkombëtar.

- Konsolidimi i kontributeve dhe rolit aktiv i Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, për një përfaqësim sa më dinjitoz në to, në zbatim të prioritetëve të politikës sonë të jashtme dhe në funksion të paqes, sigurisë dhe adresimit të sfidave të përbashkëta;
- Vijimësi e aktiviteteve në kuadër të NATO-s, si aleat i besueshëm dhe aktiv në mbështetje të vullnetit të Aleancës Atlantike, dhe unitetit të saj, për të siguruar dhe mbrojtur çdo pëllëmbë të territorit aleat. Synimi kryesor në këtë kuadër do të jenë përpjekjet politike dhe (në përputhje me kapacitetet ushtarake të vendit) ato praktike, në përfundimin më të madh të NATO-s në Lindje të territorit aleat. Shqipëria do të vijojë të kontribuojë që NATO të mbetet kolonë stabiliteti për gjeneratat e ardhshme.

- Pas përfundimit të suksesshëm të shërbimit dyvjeçar si anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit do të punohet fort për të ruajtur e shfrytëzuar në shërbim të interesave të vendit, profilin ndërkombëtar dhe reputacionin e fituar gjatë dy viteve të fundit në kuadër të KS dhe OKB.
- Nëse Shqipëria zgjidhet anëtare e Këshillit të të Drejtave të njeriut do të punohet fort që veprimtaria në kuadër të tij t'i shërbejë forcimit të profilit ndërkombëtar të rritur ndjeshëm gjatë kryesimit të OSBE dhe të mandatit në Këshillin e Sigurimit.
- Paralelisht me sa më sipër, do mbahet i njëjti ritëm i kontributeve në kuadër të organizatave ndërkombëtare, në radhë të parë të organizatave të mbështetura në sistemin e vlerave të përbashkëta me botën demokratike, siç janë OSBE dhe Këshilli i Evropës, por edhe organizata të tjera ku Shqipëria është anëtare. Synimi kryesor në Këshillin e Evropës do jetë vazhdimësia e punës për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë.

Marrëdhëniet dypalëshe, si komponent i pazëvendësueshëm për promovimin e interesave të vendit, së pari me vendet e partneritetit strategjik, por edhe me vendet e tjera me të cilat Shqipëria ruan marrëdhënie aktive politike, diplomatike, ekonomike, etj.

- Marrëdhëniet me Kosovën do vijojnë të kenë peshën dhe vëmendjen kryesore të politikës së jashtme të vendit. Synimi do jetë forcimi i bashkëpunimit dypalësh në të gjitha fushat (përfshirë edhe nëpërmjet G2G), por edhe kontributi, në koordinimin me institucionet e Kosovës, për forcimin e pozitive të Republikës së Kosovës në Rajon dhe në organizatat shumëpalëshe.
- Forcimi i kohezionit të shqiptarëve në rajon dhe maksimizimi i rolit të tyre si faktor stabiliteti në vendet ku jetojnë do vijoje të mbetet synimi kryesor i veprimtarive tona në rajon.

Disa synime konkrete të politikës së jashtme

- Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partnerët strategjik, vendet mike dhe aleate; hapja e ambasadave në Ukrainë dhe Azerbajxhan;
- Forcimi i dimensionit të diplomacisë ekonomike në përmbajtje dhe mekanizma të reja, me një qasje pro-aktive dhe gjithëpërfshirëse, si mjet i suksesshëm dhe efektiv për të maksimizuar fitimet tona kombëtare në tregti dhe investime, rritjen e bashkëveprimit ekonomik me botën e jashtme, promovimin dhe mbrojtjen e interesave kombëtare ekonomike, nxitjen e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të vendit dhe hapjen drejt qendrave të reja ekonomike botërore.
- Zbatimi i Strategjisë kombëtare të diasporës Shqiptare 2021-2025; mbështetja dhe organizimi i diasporës duke synuar rritjen e besimit të saj tek mekanizmat e zbatimit, regjistrimin e diasporës dhe rrjetëzimin e grupeve të profesionistëve në diasporë; Në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Diasporës shqiptare 2021-2025, ku parashikohet edhe roli i diplomacisë shqiptare, si më poshtë vijon:
 - Konsolidim i Diplomacisë Publike në funksion të promovimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 duke inkurajuar influencuesit e diasporës, ose “Ambasadorët e Kombit” për të avancuar imazhin pozitiv të kombit shqiptar.
 - Shënim- Me Vendimin Nr.339, datë 06.06.2018 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit “Ambasador i Kombit” ky proces është zyrtarizuar.

Institucionet shtetërore ose në bashkëpunim me vendet pritëse apo donatorë të interesuar, do të financojnë organizata gjithëpërfshirëse migrantësh..

- Në këtë kontekst, mund të organizohen veprimtari të Diplomacisë Publike që promovojnë Diasporën, si “Colours of Albania” etj.
 - Hapja e Qendrave kulturore të tjera (përveç Athinës) dhe konsolidimi i aktivitetit zhvillimor në funksion të diasporës së kësaj të fundit.
 - Së dyti, në Strategjinë Kombëtare, ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës është parashikuar edhe në bashkëpunim me shtetin e Kosovës, në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar duke ofruar shërbime e informacion për komunitetet e shqiptarëve në diasporë.
 - Regjistrimi i komuniteteve shqiptare/ sanksionimi i së drejtës për të votuar në distancë dhe përfaqësimi politik në atdhe.
 - Synohet përgatitja e kuadrit ligjor për realizimin e votimit jashtë.
 - Angazhim intensiv me të gjithë aktorët politik/grupet e interesit, shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e diasporës, për këtë qëllim .
- Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për të gjetur mundësi dhe zbatuar projekte që i sjellin shqiptarët e diasporës gjithmonë e më afër vendit të tyre. Marrëveshje me vende të ndryshme që synojnë të ndihmojnë dhe lehtësojnë jetën e përditshme të diasporës (marrëveshje për njohjen e lejeve të drejtimit dhe ato për sigurimet shoqërore);
 - Modernizimi i shërbimeve konsullore në përmbushje të detyrave që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Diasporën, duke synuar përafrimin e diasporës me vendin, identifikimin e nevojave dhe problemeve të tyre dhe ndërmjetësimi për zgjidhjen e tyre në vendin pritës; stabiliteti për gjeneratat e ardhshme.
 - Forcimi i marrëdhënieve me vendet e Rajonit dhe bashkëpunimit rajonal;
 - Konsolidim i marrëdhënieve me Kosovën, përmes G2G, zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta, angazhimit për njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, etj.
 - Forcimi i kohezionit të shqiptarëve në rajon;

Krahasuar me buxhetin e vitit 2023 projektbuxheti i vitit 2024 rezulton me një shtesë rreth 267,252,000 lekë në vlerë absolute ose në përqindje +9%.

Sipas draftit të projektbuxhetit, krahasuar me buxhetin e vitit 2022, buxheti për vitin 2023 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

në lekë

	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Buxheti vjetor
Projektbuxheti viti 2024	3,186,300,000	53,000,000	3,239,300,000
Buxheti viti 2023	2,919,048,000	52,999,000	2,972,048,000
Shtesa sipas projektbuxhetit	267,252,000	0	267,252,000

Për vitin 2024 shtesa e buxhetit në shpenzimet korrente, konsiston në rritjen e pagave të personelit të shërbimit të jashtëm në zbatim të politikave dhe vendimeve të qeverisë për rritjen e pagave të punonjësve në këtë sektor.

Me projektbuxhetin e vitit 2024, do të financohen politikat si :

1. Mbështetja financiare për funksionimin e misioneve diplomatike, ofrimin e shërbimeve konsullore si dhe përballimin e kostos për aktivitetet diplomatike të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore në funksion të objektivave politiko-diplomatike, me një **kosto rreth 2.5 miliard lekë**;
2. Mbështetja financiare për integrimin evropian si drejtim strategjik të Politikës së Jashtme. Organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, me fokus nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe me vendet anëtare të BE-së, zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve bilaterale me partner strategjik, vendet fqinje, mike dhe aleate, përfshirë diplomacinë ekonomike", me një **kosto rreth 100 milion lekë**;
3. Mbështetja financiare për konsolidimin e kontributeve dhe rolit aktiv të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, për një përfaqësim sa më dinjitoz në to, në zbatim të prioritetëve të politikës sonë të jashtme dhe në funksion të paqes, sigurisë dhe adresimit të sfidave të përbashkëta; **me një kosto rreth 150 milionë lekë**
4. Mbështetja financiare e rolit të Shqipërisë si anëtare në organizatat ndërkombëtare dhe forume shumëpalëshe, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive, përmbushjes së detyrimeve të anëtarësimit në këto organizata dhe për dhënien e kontributit tonën modest në çështjet e paqes dhe të sigurisë në planin ndërkombëtar, me një **kosto rreth 233 milion lekë**;
5. Mbështetja dhe organizimi i diasporës shqiptare, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Diasporës duke synuar rritjen e besimit të saj tek mekanizmat e zbatimit, regjistrimin e diasporës dhe rrjetëzimin e grupeve të profesionistëve në diasporë, me një **kosto rreth 120 milionë lekë**; (buxheti i Agjencinë Kombëtare të Diasporës si dhe e Qendrës së Studimit dhe Publikimit të Arbëreshëve).

Në lidhje me investimet publike, projektbuxheti i vitit 2024 financon projekte në vlerë totale **53milionë lekë**. Konkretisht:

- *Për aparatin e MEPJ:*

Blerje pajisje kompjuterike 9 milion lekë;
Blerje pajisje zyre 5,000,000 milion lekë;
Rikonstrukcion i ambienteve të ministrisë 22 milion lekë;

- *Për përfaqësitë diplomatike:*

Blerje automjete për misionet diplomatike 8 milion lekë;
Blerje pajisje kompjuterike 4 milion lekë;
Blerje pajisje zyre 3 milion lekë;

- *Për Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhe Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët:*

Data basë për regjistrimin e diasporës 8 milion lekë;
E drejta e autorit 1 milion lekë;
Blerje pajisje kompjuterike 1 milion lekë;
Blerje pajisje zyre 1 milion lekë.

Numri i punonjësve të MEPJ për vitin 2024 do të jetë me 561 punonjës, nga të cilët:

- 368 punonjës në përfaqësitë diplomatike, përfshirë këtu edhe 12 punonjës të cilët plotësojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore për përballimin me sukses të anëtarësimit në këshillin e Sigurimit të OKB.

- 198 punonjës në aparatit e MEPJ, përfshirë këtu edhe 28 punonjësit e dy institucioneve të diasporës (AKD dhe QSPA).

➤ EFEKTET FINANCIARE

Sa i takon efekteve financiare, referuar relacionit të MEPJ mbi programet buxhetore, shtesa e buxhetit sipas draftit të projektbuxhetit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Programet buxhetore të MEPJ	Buxheti 2023	Projektbuxheti 2024	Shtuar në vlerë absolute dhe në përqindje	
01110 "Planifikim menaxhim Administrim"	317,772,000	354,800,000	+37,028,000	12%
01120 "Mbështetje diplomatike jashtë vendit"	2,408,776,000	2,568,000,000	+159,224,000	7%
01130 "Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ"	245,500,000	316,500,000	+71,000,000	29%
Totali i buxhetit vjetor:	2,972,048,000	3,239,300,000	267,252,000	9%

DISKUTIMET NË KOMISION

Znj. Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit, fillimisht ia dha fjalën z. Igli Hasani, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ministri Hasani, në paraqitjen e tij, theksoi se projektbuxheti i MEPJ për vitin 2024 është rreth 3.2 miliard lekë. Krahasuar me buxhetin e vitit 2023 projektbuxheti i vitit 2024 rezulton me një shtesë rreth 267,252,000 lekë në vlerë absolute ose në përqindje +9%. Ky buxhet mundëson vazhdimin normal të përfaqësimit të Shqipërisë në shtetet ku jemi akredituar, si dhe zbatimin e strategjive, politikave dhe objektivave të shërbimit të jashtëm.

Më tej, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme informoi Komisionin se orientuar nga prioritetet e politikës së jashtme, projektbuxheti i vitit 2024 mundëson realizimin e disa objektivave që kanë të bëjnë me drejtimit e mëposhtme:

Integrimi Evropian si drejtim strategjik i Politikës së Jashtme

Vijimi i angazhimit politik e diplomatik të MEPJ dhe përfaqësive të veta në shtetet anëtare të BE për avancimin e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, do të mbetet një prioritet absolut i

diplomacisë shqiptare. Po ashtu do të vazhdojë puna për forcimin e dialogut me institucionet e BE, në të gjitha nivelet dhe formatet, lidhur me çështje të politikës së përbashkët të jashtme e të sigurisë, përfshirë sanksionet e BE dhe zbatimin e tyre në territorin shqiptar;

Veprimtari në kuadër të organizatave ndërkombëtare

Fusha e diplomacisë shumëpalëshe do vazhdojë të jetë në vëmendjen e Politikës së jashtme dhe të gjithë strukturave të shërbimit të jashtëm, duke shpërfaqur vlerat e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, dhe duke dhënë kontributin tonë modest për çështjet e paqes dhe të sigurisë në planin ndërkombëtar. Konsolidimi i kontributeve dhe rolit aktiv i Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, për një përfaqësim sa më dinjitoz në to, në zbatim të prioriteteve të politikës sonë të jashtme dhe në funksion të paqes, sigurisë dhe adresimit të sfidave të përbashkëta;

Marrëdhëniet dypalëshe

Marrëdhëniet dypalëshe, si komponent i pazëvendësueshëm për promovimin e interesave të vendit, së pari me vendet e partneritetit strategjik, por edhe me vendet e tjera me të cilat Shqipëria ruan marrëdhënie aktive politike, diplomatike, ekonomike, etj. Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partnerët strategjik, vendet mike dhe aleate; hapja e ambasadave në Ukrainë dhe Azerbajxhan;

Marrëdhëniet me Kosovën do vijojnë të kenë peshën dhe vëmendjen kryesore të politikës së jashtme të vendit. Synimi do jetë forcimi i bashkëpunimit dypalësh në të gjitha fushat (përfshirë edhe nëpërmjet G2G), por edhe kontributi, në koordinimin me institucionet e Kosovës, për forcimin e pozitave të Republikës së Kosovës në Rajon dhe në organizatat shumëpalëshe.

Forcimi i marrëdhënieve me vendet e Rajonit dhe bashkëpunimit rajonal .

Disa synime të tjera konkrete të politikës së jashtme

Zbatimi i Strategjisë kombëtare të diasporës Shqiptare 2021-2025; mbështetja dhe organizimi i diasporës duke synuar rritjen e besimit të saj tek mekanizmat e zbatimit, regjistrimin e diasporës dhe rrjetëzimin e grupeve të profesionistëve në diasporë. Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës është parashikuar edhe në bashkëpunim me shtetin e Kosovës, në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar duke ofruar shërbime e informacion për komunitetet e shqiptarëve në diasporë.

Forcimi i kohezionit të shqiptarëve në rajon dhe maksimizimi i rolit të tyre si faktor stabiliteti në vendet ku jetojnë do vijojë të mbetet synimi kryesor i veprimtarive tona në rajon.

Një tjetër drejtim është edhe forcimi dhe konsolidim i Diplomacisë Publike.

Funksionimi i sistemit të shërbimit të jashtëm

Me projektbuxhetin e vitit 2024, do të realizohet mbështetja financiare për funksionimin e misioneve diplomatike, ofrimin e shërbimeve konsullore si dhe përballimin e kostos për aktivitetet diplomatike të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore në funksion të objektivave politiko-diplomatike.

Gjithashtu për vitin 2024 shtesa e buxhetit në shpenzimet korrente, përfshin edhe rritjen e pagave të personelit të shërbimit të jashtëm në zbatim të politikave dhe vendimeve të qeverise për rritjen e pagave të punonjësve në këtë sektor.

Me projektbuxhetin e vitit 2024, do të realizohet mbështetja financiare për funksionimin e misioneve diplomatike, ofrimin e shërbimeve konsullore si dhe përbalimin e kostos për aktivitetet diplomatike të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore në funksion të objektivave politiko-diplomatike.

Z. Blendi Klosi, Zëvendëskryetar i Komisionit, në cilësinë e relatorit, falënderoi z. Igli Hasani, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme për prezantimin e hollësishëm dhe tha se mbështetja e Komisionit për Politikën e Jashtme nuk do të mungojë, jo vetëm në këtë moment të miratimit të buxhetit për vitin e ardhshëm por gjatë gjithë vitit. Në vijim ai tha se rritja në buxhet që ky dikaster ka marë për këtë vit do ti shërbejë lartësimit në arenën ndërkombëtare të rolit të Shqipërisë.

Më tej, anëtarët e Komisionit bënë pyetje dhe diskutuan mbi projektbuxhetin. Duke vlerësuar rritjen e tij krahasuar me atë të një viti më parë ata shprehën interesimin dhe sugjerimet e tyre lidhur me mundësitë e tij për përmbushjen optimale dhe efektive të objektivave të politikës së jashtme.

Znj. Mimi Kodheli, shprehu gjithashtu përgëzimet e saj për rritjen e buxhetit prej 9 përqind dhe theksoi se të gjitha shtyllat e prezantuar nga Ministri Hasani kanë një rëndësi të veçantë. Ajo sugjeroi rishikimin e shpërndarjes së trupës diplomatike shqiptare për të pasur një mbulim që i përgjigjet zhvillimeve të kohës, një koment ky që u mirëprit nga ministri.

Në përfundim të diskutimeve, ajo falënderoi të gjithë kolegët për kontributin e tyre dhe ftoi Komisionin për të votuar projektligjin në parim.

PËRFUNDIME

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën, nenet 78,83, pika 1 dhe 158 të saj dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi **në parim** buxhetin 2024 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe, pasi e miratoi atë u shpreh dakord për kalimin e tij tek Komisioni për Ekonominë dhe Financat si komision përgjegjës për shqyrtim, miratim dhe paraqitje të projektligjit “ Për Buxhetin e vitit 2024” në seancë plenare.

RELATOR

Blendi KLOSI

KRYETARE

Mimi KODHELI